



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJES

I.Numër:463-01/36014, dt. 28 Maj 2024.

Në bazë të nenit 11, nenit 12 par.2 pika d, nenit 14 par.1 të Ligjit për Vetqeverisjen Lokale nr. 03/L-40 të datës 20 shkurt 2008 të nenëve 5,6,8 dhe 14 të Ligjit nr. 06/L-092 mbi dhënjen në shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme Komunës, nenëve 5,6,8 dhe 14 të rregullores (QRK) Nr.09/2020 për përcaktimin e Procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe nenit 20 paragrafi 1 pika 1.4 të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431.dt.30. shtator 2020, pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme komunale në objekt të komunës –dy sportele për aktivitete bankare, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me date: 28 Maj 2024, merr këtë:

**VENDIM
Nr. 16/2024**

Mbi miratimin paraprak për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale në objekt të komunës dy (2) sportele për aktivitete bankare

I. Miratohet propozimi - i Kryetarit të Komunës miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme komunale në objekt të komunës - dy (2) sportele për aktivitete bankare në afat prej tri (3) viteve sipas Vendimit të Kuvendit Komunal nr.463-01/117215 datë 28 dhjetor të Listes së veçantë të pronave të miratuara për dhënien në shfrytëzim gjatë vitit 2024.

Nr.	PRONARI Poseduesi	Emri i rrugës (lokacioni)	Sipërfaqja	Zona Kadastrale	Destinimi	Periudha	Vërejtje
1	Komuna Pejë	Rr.Hasan Prishtina- Objekti i Komunës	Sportelet 1. 5.8 m ² 2. 5.8 m ²	Pejë	Dy(2) sportele për aktivitete bankare	Tri(3) vite	

II.Pas plotësimit të kushteve ligjore komisioni per komunal per vlersimin e ofertave do të inicoj procedurën e tenderimit - ankandit publik, për zgjedhjen e ofertes më të favorshëme për dhënien në shfrytëzim të këtyre dy (2) sporteleve për aktivitete bankare.

III.Për zbatimin e këtij Vendimi dhe dispozitave të ligjit për dhënjen në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, obligohet që të kujdeset Komisioni Vlersuesë, Drejtorija për Çështje Pronëso-ro-Juridike.

IV.Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe 7 (shtatë) pas publikimit në ëeb faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi ti dërgohet:
MAPL-së,
Kryetarit të Komunës,
DÇPJ,
Arkiv.

